Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Lubjanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

RAPORTI VJETOR 2022

Maj 23, 2023

→ *Përmbajtja* ←

KAPITULLI I

1. Përmbledhje ekzekutive 5
2. Metodologjia 6
3. Periudha raportuese 7
    3.1. Periudha Raportuese: Prill 2021 - Qershor 2022 8
    3.2. Periudha Raportuese: Qershor 2022 - Dhjetor 2022 8
4. Misioni i OSHP 9
5. Legjislacioni 10
6. Kompetencat e OSHP 11,12
7. Organizimi Institucional 13
    7.1. Bordi dhe Administrata 14
    7.2. Struktura e të punësuarve 14
    7.3. Lëvizjet e stafit 15
    7.4. Organogrami 16
    7.5. Trajnimet 16
8. Sfidat 17
8.1. Nevojat për punëtor të rijë 18
9. Marrëdhëniet me publikun 19
10. Asetet 19
11. Donatorët 20
12. Bashkëpunimi i jashtëm 20
13. Gjetjet e auditorit 20

KAPITULLI II

14. Shqyrtimi i ankesave 22
    14.1. Numri i ankesave sipas periudhës raportuese 22
    14.2. Lista e vendimeve dhe ankesave 23
    14.3. Pasqyra vjetore e ankesave Janar-Dhjetor 23
    14.3. Klasifikimi i ankesave ne bazë të vlerës 23
15. Ndërmarrja e masave 24
    15.1. Urdhrat ndaj AK 25
    15.2. Gjobat ndaj AK 26
    15.3 Masat ndaj Zyrtarëve të prokurimit 27
16. Masat ndaj OE 28
    16.1. Gjobat 28
    16.2. Diskualifikimi 29
17. Vendimet e Gjykatave 30
    17.1. Paditë e refuzuara 30
    17.2. Paditë e aprovuara 31
    17.3. Ankesat në Gjykatën e Apelit 31
    17.4. Kërkesat e aprovuara për shtyrje të ekzekutimit të vendimit 31
    17.5. Kërkesat e refuzuara për shtyrje të ekzekutimit të vendimit 31
Aneksi 1. Të dhënat e detajuara të vendimeve Janar-Dhjetor 2022 34
Aneksi 3. Krahasimi i lëndëve të shqyrtuara, vitet 2020, 2021, 2022 40
Përqindja e Tarifave ankimore 41
Aneksi 4.Të dhënat buxhetore 42

Shkurtesat

OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
LPP	Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës
LPPA	Ligji për procedurën e përgjithshme administrative
BE	Bashkimi Evropian
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
AK	Autoritetet kontraktuese
OE	Operatorët ekonomik
DT	Dosja e Tenderit
ST	Specifikimet Teknike
AP	Aktiviteti i Prokurimit
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
USAID	U.S. Agency for International Development
SIGMA	Nismë e përbashkët e OECD dhe Bashkimit Evropian
GIZ	Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit
MB	Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar

KAPITULLI I.

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti Vjetor 2022, i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) është përpiluar në pajtim me dispozitat e nenit 120 (Raportimi në Kuvend) dhe 121 (Dërgimi i informacioneve), të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës (versioni i amandamentuar) lidhur me nenin 43 (Mbikëqyrja dhe performanca e agjencive të pavarura), të Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura dhe i prezantohet Komisionit Parlamentar për Punë, Buxhet dhe Transfere të Kuvendit të Republikës së Kosovës, lidhur me përmbushjen e detyrimit raportues.

Raporti në rastin konkret, i referohet periudhës kohore të vitit 2022 dhe i njëjti paraqet një pasqyrim të aktiviteteve të realizuara, sikurse kërkohet në mënyrë specifike me paragrafin 1, të nenit 121 të të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës (LPP) sipas të cilit shprehimisht parashihet se, *cituar:* "Për çdo vit kalendarik, OSHP do t'i sigurojë Kuvendit, më së voni deri në fund të shkurtit të vitit pasues kalendarik, informacionet dhe të dhënat në vijim, sipas llojeve të procedurave dhe objekteve të aktivitetit përkatës të prokurimit".

Organi Shqyrtues i Prokurimit, ushtron pavarësinë e plotë institucionale në zbatimin e mandatit të tij ligjor në harmoni me nenin 98, ushtron përgjegjësitë dhe kompetencat e parashikuara dhe/ose të renditura taksativisht me dispozitën e nenit 99, lidhur me nenin 103 dhe 105, në harmoni me parimet e bazë të prokurimit publik të sanksionuara në Kreun II, lidhur me nenin 104 dhe drejtohet në të gjitha pikëpamjet në ushtrimin e funksioneve parësore të tij/sajë (në vend dhe jashtë) nga Kryetari i OSHP dhe Bordi i këtij Institucioni, të cilët emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, në harmoni me nenin 100 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, është një nga institucionet qendrore të administratës shtetërore, i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në pajtim me dispozitën nenit 65, lidhur me dispozitën e nenit 142, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe i cili në bazë të Ligjit për Prokurimin Publik, ushtron juridiksion ekskluziv lidhur me zgjidhjen e të gjitha çështjeve kontestuese për aktivitetet e prokurimit publik, të iniciuara nga të gjitha entitetet shtetërore dhe publike, kur ato veprojnë në cilësinë e AK (në nivelin qendror dhe lokal) dhe OE nga ana tjetër, përfshirë ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të cilat konsiderohen si të nevojshme dhe të arsyeshme, bazuar në diskrecion dhe pavarësinë e garantuar institucionale, në procesin e vlerësimit dhe të vendosjes meritore.

2. METODOLOGJIA

Raporti vjetor 2022, përbëhet nga informatat bazë, të nevojshme për informimin e rregullt të Komisionit Parlamentar për Punë, Buxhet dhe Transfere të Kuvendit të Kosovës, të cilat si të tilla rezultojnë nga konteksti i nenit 121 të LPP. Raporti përmban një prezantim dhe përshkrim të preciz të dhënave të cituara, të përmbledhura dhe të shoqëruara me shpjegimet e nevojshme përkitazi me gjendjen paraprake, mandatin dhe ndryshimet. Kurse, niveli i të dhënave dhe kualiteti i tyre burojnë nga arkivi dhe dokumentacioni në dispozicion të OSHP. Raporti përmban dhe materiale statistikore, duke ju përmbajtur formatit të raporteve të rregullta vjetore për nga struktura e tyre institucionale dhe përfshinë edhe disa nga format e mundshme vizuale, tabelare dhe grafike të paraqitjes së të dhënave, të bashkëngjitura si anekse.

Raporti vjetor në ketë rast, është dërguar në Komisionin Parlamentar për Punë, Buxhet dhe Transfere sikurse kërkohej me nenin 120 dhe 121 të LPP. Mirëpo, nisur nga sugjerimet dhe debatet në nivel të Komisionit, është kërkuar që i njëjti t'i nënshtrohet korrigjimeve të rekomanduara, ngase është konsideruar e nevojshme për plotësimin e standardeve minimale të këtij dokumenti në funksion të procesit raportues. Prandaj, janë bërë përpjekje që ky Raport ti elaboroj dhe të karakterizohet me informata përmes të cilave pasqyrohet progresi në zbatimin e kompetencave primare, progresin e arritur, objektivat që synohen, sfidat dhe iniciativat në vijim të ushtrimit të mandatit.

Duke ju referuar sugjerimeve profesionale të Komisionit, ky Raport hartohet nën kujdesin e drejtë për drejte të Kryetares së OSHP e cila sipas nenit 102 të LPP, përfaqëson, menaxhon, organizon dhe është përgjegjës/e për mbikëqyrjen e administrimit të përditshëm dhe veprimtarisë së rregullt të Institucionit, monitorimin e rregullt dhe zbatimit të standardeve të Kodit të etikës dhe punës profesionale, duke nënkuptuar në ketë rast dhe detyrimin për raportim. Bazuar në rekomandimet e dhëna nga ana e Komisionit Parlamentar dhe njëherësh duke i pasur për bazë orientimet parimore nga aspekti metodologjik, raporti përmban por nuk kufizohet në të dhënat si në vijim:

- Numri i Lëndëve, respektivisht ankesave të dorëzuara nga operatoret ekonomik, brenda vitit kalendarik 2022, të cilat parashtrohen në OSHP, në kuptim të nenit 109 të LPP;
- Numri i vendimeve të Bordit-Paneleve shqyrtuese, të cilat veprojnë nga cilësia e tyre si kolegje profesionale përkitazi me vendosjen meritore, në kuptim të nenit 105 të LPP;
- Numri i ankesave të pazgjidhura, diskualifikimet, gjobat e nevojshme, e tjera;
- Duke i përfshirë për të gjitha rastet e cituara si më sipër edhe llojet e tyre;

Në fakt, të dhënat në dispozicion, të cilat janë përfshirë dhe prezantuar në përmbajtjen e këtij Raporti, kanë determinuar domosdo nevojën që ato shkurtimisht të shoqërohen me shpjegime, meqë të njëjtat reflektojnë:

- Periudhën nga muaji Prill 2021 deri në Qershor 2022;
- Periudhën nga data 22 Qershor dhe në vijim.

3. PERIUDHA RAPORTUESE

3.1. Periudha raportuese: Prill 2021 - Qershor 2022

Sikurse është tani më e ditur, në periudhën kohore nga muaji prill 2021 deri me datën 23 qershor 2022, OSHP ka funksionuar pa Bord, sepse Bordit në përbërjen paraprake i kishte skaduar mandati në mars të vitit 2021. Mirëpo edhe gjatë kësaj periudhe OSHP i ka pranuar të gjitha ankesat e parashtruara nga operatorët ekonomik, meqë detyrimi për ti pranuar ankesat i referohet nenit 109 të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pas zbatimit të procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve, sikurse parashihet me nenin 108/A të këtij ligji.

Ankesat e ushtruara subjektet, të cilët kanë statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet me nenin 105, paragrafi 1, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP, të cilat janë ushtruar brenda afatit ligjor sipas paragrafi 2, të nenit 109 dhe konsiderohen të kompletuara sikurse kërkohet me nenin 111 lidhur me nenin 118 të LPP, bijën nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP, lidhur me nenin 9, të Rregullores për Punën e OSHP.

Bazuar në shpjegimet e cituara shkurtimisht si më sipër, ankesat e ushtruara në ketë rast i janë nënshtruar fazave të mëtejme të shqyrtimit administrativ, respektivisht shqyrtimit preliminar nga ekspertët shqyrtues, sikurse kërkohet me dispozitat e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, mirëpo në mungesë të Bordit, të njëjtat nuk i janë nënshtruar shqyrtimit dhe vendosjes meritore. Përderisa, ankesat të cilat nuk kanë qenë të kompletuara, sikurse kërkohet kjo shprehimisht me dispozitat e cituara si më sipër, janë hedhur si të ankesa të parregullta nga kryesuesi i Sekretariatit, bazuar në Rregulloren e Punës së OSHP, Nr. 01/2020.

3.2. Periudha raportuese: Qershor 2022 – Dhjetor 2022

Sikurse është theksuar më sipër, Kuvendi i Republikës së Kosovës me 23.06.2022, ka emëruar Bordin e OSHP, në përbërje të plotë, siç parashihet me nenin 100 të LPP, të cilit i adresohen përgjegjësitë kryesore për zbatimin e Ligjit për Prokurimin Publik, të parapara në mënyrë specifike me nenin 105 (Kompetencat e OSHP), sipas të cilit OSHP ka kompetenca, autoritet, pushtet dhe përgjegjësi, ti shqyrtojnë ankesat nga palët e interesuara lidhur me shkeljet e mundshme të këtij ligji dhe të hetoj faktet që kanë shkaktuar ankesat e tilla. Prandaj nisur nga shkaqet dhe arsyet e cituara shkurtimisht si më sipër dhe meqë një numër i konsiderueshëm i ankesave ishin përfshirën nën juridiksionin ekskluziv të OSHP, Kryetarja në bashkëveprim me Bordin kanë analizuar me urgjencë gjendjen paraprake, kryesisht lidhur me ankesat e ushtruara, me ç'rast për periudhën

kohore nga muaji prill 2021 deri në qershor 2022 (gjatë së cilës OSHP nuk ka pasur Bord) domosdo duhej marrë në konsideratë së paku faktet si në vijim:

- ankesave të dorëzuara ju kishte skaduar çdo afat për të vendosur në mënyrë meritore;
- kanë pasuar ndryshime qenësore të cilat janë karakterizuar me ndryshime të papritura në tregjet afariste;
- kanë pasuar ndryshime në planifikimet buxhetore të autoriteteve kontraktuese për vitin 2022;

Nisur nga rrethanat e shpjeguara si më sipër, me 12.07.2022, Bordi ka marr vendim që të gjitha ankesat, të cilave iu kishte kaluar çdo afat ligjor për vendimmarrje, të mos i nënshtrohen procesit të vendimmarrjes, por të hidhen si të jashtë afatshme për shqyrtim dhe vendosje meritore, kurse të gjithë OE-ve nga cilësia e tyre si ankues, u janë kthyer mjetet e deponuara në emrin e tarifës ankimore, në kuptim të nenit 118 të LPP. Kështu Bordi i OSHP ka ndërmarrë në ketë rast veprime të domosdoshme brenda autorizimeve të parapara me LPP, për zbatimin e një zgjidhjeje më të mirë të mundshme, duke arritur që ta funksionalizoj OSHP dhe duke marrë vendime në vijim, pothuajse për të gjitha ankesat e parashtruara në vitin 2022.

Si rezultat i këtyre angazhimeve, duke punuar në mënyrë konstante dhe jashtë orarit, Bordi i OSHP në bashkëpunim me stafin, ka arritur që gjatë këtij viti t'i trajtoj pothuajse të gjitha ankesat dhe kërkesat e parashtruara, duke i realizuar në mënyrë efektive funksionet dhe kompetencat e OSHP, në zbatim të nenit 99 të LPP, sipas të cilit, *cituar:* "OSHP është përgjegjëse për zbatimin e procedurave për shqyrtimin e prokurimit sipas Pjesës IX të këtij ligji dhe kanë autoritetin dhe përgjegjësitë e parashikuara në atë Pjesë".

4. MISIONI I OSHP

Me 23.06.2022, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka emëruar Bordin e OSHP, në përbërje të plotë, sikurse parashihet me nenin 100 të LPP, të cilit i adresohen përgjegjësitë kryesore për zbatimin e Ligjit për Prokurimin Publik. Në të vërtetë, ligji i cituar konsiderohet si njëri nga legjislacionet kyçe në procesin e shfrytëzimit të parasë publike, dedikimi i të cilave manifestohet kryesisht përmes synimeve institucionale (respektivisht AK) për realizimin e interesave me karakter publik, të cilat paraprakisht identifikohen si të tilla në kuptim të nenit 8 (planifikimi i prokurimit) dhe nenit 9 (përcaktimi i nevojave) kurse vihen në dispozicion të publikut, respektivisht OE, me shpalljen e dosjes së tenderit e cila në kontekstin e nenit 27 të LPP, nënkupton dokumentin kyç për implementimin e aktivitetit të prokurimit publik. Prandaj, jo vetëm për Kosovën por për të gjitha vendet e BE, prokurimi publik prezanton një nga sektorët publik me rëndësi strategjike për ç' arsye Bordi i OSHP (në ketë përbërje) është duke e drejtuar me kompetencë dhe me përgjegjësi ketë Institucion, duke i kushtuar kujdesin e duhur realizimit efektiv të mandatit, duke i vendosur në rangun e përparësive, objektivat si:

a) Përmbushja e *qëllimeve bazë* të LPP, të cilat në kuptim të nenit 1 të LPP, konsistojnë në:

- Sigurimin e shfrytëzimit efikas dhe të drejtë të fondeve publike nga ana e AK;
- Sigurimin e përgjegjësisë dhe integritetit në procesin e prokurimit publik,
- Sigurimin e barazisë, ekonomizimit dhe transparencës;
- Promovimin e një kulture institucionale dhe profesionale;

b) Ngritja së *kapaciteteve profesionale* të OSHP, të cilat janë më së të domosdoshme për:

- Përmbushjen e qëllimeve bazë të legjislacionit vendor, të shpjeguara si më sipër;
- Përgatitjen e OSHP, proceset e Integrimit Evropian, të cilat në kontekstin e prokurimit publik, parashihen shprehimisht me dispozitën e nenit 79 të MSA (Prokurimi Publik).

Në fakt, pas nënshkrimit të MSA, BE mori vendim për nisjen e negociatave për MSA ndërmjet Kosovës dhe BE-së, të cilat natyrisht se kanë filluar në raunde dhe përkitazi me plotësimin e detyrave të caktuara. Lidhur me ketë, neni 79 (Prokurimi Publik) i MSA përmban 9 paragraf të cilët shprehimisht parashohin detyra për autoritetet shtetërore të Republikës së Kosovës, siç thuhet, cituar "*për zbatim të rregullave të prokurimit të BE" (paragrafi 2)*. Në kontekstin e këtyre zhvillimeve, Bordi i OSHP angazhohet mes tjerash dhe në përmirësimin e punës profesionale të këtij Organi, i cili në fakt (në raport me entitetet tjera të prokurimit) ushtron funksionet më sfiduese në sistemin e prokurimit publik. Aq më tepër, vendimet për zgjidhjen e çështjeve me karakter kontestues mes palëve, padyshim se në të ardhmen do ti përfshinë nën juridiksion edhe operatorët ekonomik nga vende të ndryshme të BE.

Bordi konsideron se realizimi i objektivave si më sipër, është nevojshme për të krijuar ndryshime pozitive në punën e OSHP dhe për paraqitur një *raportim cilësor* para Kuvendit të Republikës së Kosovës, respektivisht Komisionit për Punë, Buxhet dhe Transfere, të cilin OSHP është e obliguar që rregullisht ta vejë drejtpërdrejtë në dijeni, lidhur me të gjitha informacionet e kërkuara me dispozitat e neneve 120 dhe 121, të LPP, përfshirë të arriturat dhe sfidat, objektivat dhe planifikimet për të ardhmen.

Mirëpo të dhënat në dispozicion, të cilat janë përfshirë dhe prezantuar në përmbajtjen e këtij Raporti, kanë determinuar domosdo nevojën që ato (shkurtimisht) të shoqërohen me shpjegime, meqë objektivisht e reflektojnë:

- Periudhën nga muaji Prill 2021 deri në Qershor 2022;
- Periudhën nga data 22 Qershor dhe në vijim;

5. LEGJISLACIONI

Legjislacioni primar

konsiston në Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës. Në fakt, Ligji i cituar është amandamentuar disa herë, përfshirë në këtë rast Ligjin Nr. 04/L-237 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës; Ligjin Nr. 05/L-068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës; Ligjin Nr. 05/L-092 për Ndryshimin dhe Plotësimit e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës; Ligjin Nr. 04/L-237 dhe me Ligjin Nr. 05/L-068.

Amendamentet

Të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e radhitura si më sipër konsiderohen pjesë integrale e Ligjit Nr. 04/L-042 në versionin e tij të amandamentuar, megjithatë pritet që legjislacioni në fuqi, sërish ti nënshtrohet ndryshimeve meqë Ministria e Financave ka publikuar draft ligjin e ri të Ligjit për Prokurimin Publik, por i njëjti është ende në proces të përgatitjes dhe përpunimit dhe pritet të miratohet gjatë vitit 2023.

Legjislacioni sekondar

konsiston në të gjitha aktet nënligjore të aprovuara nga Komisionit Rregullativ i Prokurimit Publik dhe OSHP, të cilat mes tjerash përfshinë Rregulloren për Punën e Organit Shqyrtues të Prokurimit; Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik (RRUOPP); Rregulloren për Prokurim Publik; Udhëzues Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik;

6. KOMPETENCAT E OSHP

Sipas nenit 98 të LPP, OSHP është një nga organet e administratës qendrorë të Republikës së Kosovës dhe i pavarur në ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësive, të cilat janë përkufizuar me nenin 99 të këtij Ligji sipas të cilit, OSHP është përgjegjëse për zbatimin e procedurave për shqyrtimin e prokurimit sipas Pjesës IX të këtij ligji. Në ketë rast, në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të saja gjatë procesit të vendimmarrjes, OSHP e ushtron autoritetin e vendimmarrjes në nivel të paneleve shqyrtuese, në përbërje nga 1/një, 3/tre ose 5/pesë anëtarë, sipas nenin 106 të LPP lidhur me nenin 17, 21 të Rregullores për Punën e OSHP, varësisht nga vlera e kontratës, natyra komplekse dhe rëndësia e çështjes.

Panelet shqyrtuese (të cilat veprojnë në cilësinë e kolegjeve profesionale) udhëhiqen apriori nga parimet bazë, të sanksionuara mes tjerash me dispozitën e nenit 104, sipas të cilit të gjitha palët do të kenë qasje të barabartë në procedurat e shqyrtimit dhe në përdorimin e mjetit juridik dhe se asnjë vendim nuk do të merret me pasoja të pabarazisë, diskriminimit në të mirë ose dëm të një subjekti. Në mënyrë specifike, kompetencat e OSHP janë radhitura në mënyrë taksative në dispozitën e nenit 105 të LPP, sipas të cilit Panelet Shqyrtuese kanë përgjegjësi që ti shqyrtojnë të gjitha shkeljet e mundshme të këtij ligji, duke i adresuar detyrimet për ndërmarrjen e veprimeve si në vijim:

(a) Secili Panel Shqyrtues është i detyruar që, në varësi të shkallës dhe natyrës së shkeljeve:

- të dorëzojë të dhëna, dokumente ose për tu paraqitur në seancën e shqyrtimit publik dhe të japë dëshmi lidhur me çdo çështje që paneli shqyrtues në ushtrimin e arsyeshëm në diskrecion të tij, e konsideron relevante për të verifikuar pretendimet e palëve;

(b) Secili Panel Shqyrtues është i detyruar që, në varësi të shkallës dhe natyrës së shkeljeve:

- t'i japin urdhër AK që ta pezulloj ose përfundoj zbatimin e aktivitetit të prokurimit ose vendimit të tij/sajë. Si dhe, të anuloj ose revokoj vendimin e tij/sajë i marrë si pasojë e specifikave dhe/ose kushteve e paligjshme të vendosura në dosjen e tenderit, i cili konsiderohet një nga dokumentet kyçe në aktivitetin e prokurimit dhe ti evitoj shkeljet dhe/ose të parandalojë dëmtimin eventual të ndonjë pale të interesuar;

(c) Secili Panel Shqyrtues është i detyruar që, në varësi të shkallës dhe natyrës së shkeljeve:

- lëshoj një urdhër i cili e shndërron një kontrate të nënshkruar në infektive, nëse janë vërtetuar shkelje të nenit 42 dhe nenit 26 i këtij ligji dhe t'i imponoj gjoba, nëse autoriteti kontraktues, në varësi të shkeljeve dhe vlerësimit të pavarur të tij/sajë;

OSHP konsideron se secili AK (në çdo nivel, qendror dhe lokal) ushtron autonominë institucionale në planifikimin e nevojave dhe përmbushjen e tyre, të cilat i garantohen me dispozitat e nenit 8 dhe 9 dhe ka të drejtë ta përpiloj DT në kuptim të nenit 27 të LPP, sipas të cilit, *cituar:* "autoriteti kontraktues do të përpiloj një dosje të tenderit që ofron informatat përkatëse lidhur me kontratën

në fjalë duke përfshirë të gjitha termet dhe kushtet materiale të saj... çfarëdo kërkese të aplikueshme të përshtatshmërisë ose ndonjë kriter të përzgjedhjes...”. Në kuptim të kësaj dispozite, DT përbën dokumentin kryesor të prokurimit dhe se publikimi i sajë supozohet të jetë në harmoni të plotë me qëllimet e LPP, me synimet që të siguroj mënyrën efikase të shfrytëzimit të fondeve publike dhe të promovoj integritetin e prokurimit publik.

OSHP vëren se në raste, disa nga AK kanë marrë vendime për anulimin (pa bazë) të një aktiviteti të prokurimit, me ç ‘rast ushtrimi i kompetencave dhe ligjshmëria në fushën e prokurimit publik, vihet në dilemë. OSHP ka parasysh faktin se praktikat e mira dhe standardet e prokurimit ndërkombëtar nuk e pranojnë anulimin e një aktivitetit të prokurimit në çdo fazë dhe për çfarëdo arsyeje. OSHP, është e përkushtuar që në procesin e vendimmarrjes të promovoj profesionalizmin dhe etikën profesionale dhe kulturën institucionale për vetëdijesimin e OE të cilët ushtrojnë ankesa pa bazë juridike ose për prolongim të procesit të prokurimit, duke e zbatuar si masë të zakonshme konfiskimin e tarifës ankimore, të cilat transferohen në Buxhetin e Kosovës.

OSHP angazhohet në mënyrë konstante për trajtimin e të gjitha ankesave të parashtruara nga OE në mënyrë sa më profesionale dhe meritore. Në të gjitha rastet, secili Paneli shqyrtues synon që vendimet të bazohen në administrimin e të gjitha provave në dispozicion të një lënde duke i pasur gjithmonë parasysh porositë e ligjdhënësit të sanksionuara në nenin 1 të LPP, sipas të cilit qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, të promovoj përgjegjësinë, profesionalizmin dhe kulturën institucionale në fushën e prokurimit publik.

7. ORGANIZIMI INSTITUCIONAL

Bordi i OSHP, përbëhet nga pesë (5) anëtarë, të cilët emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me mandat pesë (5) vjeçar, pa të drejtë riemërimi. Sikurse parashihet me nenin 100 të LPP, nëntëdhjetë ditë para skadimit të mandatit të kryetarit dhe anëtarëve aktualë, Qeveria e Kosovës i propozon Kuvendit së paku nga dy kandidatë për pozitën e kryetarit dhe secilën pozitë të anëtarëve të Bordit. Në ketë rast, Kuvendi emëron kryetarin dhe anëtarët e Bordit të OSHP, bazuar paraprakisht në rekomandimin e dhënë nga një organ përzgjedhës i pavarur, i cili interviston, vlerëson kandidatët potencial bazuar në meritat e tyre profesionale.

Bordi i OSHP, në përbërjen aktuale, ka filluar punën me 24 qershor 2022, gjë që sipas dispozitës së cituar si më sipër (nenit 100) në raport me aktin e emërtimit, rezulton se mandati i këtij Bordi përfundon në qershor të vitit 2027. Aktualisht Bordi përbëhet nga Kryetarja e OSHP, e cila njëkohësisht caktohet si anëtare e paneleve shqyrtuese dhe 3/tre anëtarë të Bordit, pasi që një nga anëtaret ka thënë dorëheqje me datën 25 tetor 2022.

Sipas autorizimeve të parapara me nenin 102 të LPP, Kryetari përfaqëson, drejton, organizon dhe është përgjegjës për ushtrimin e rregullt të funksioneve dhe mbikëqyrjen e administrimit të përditshëm të veprimtarisë së OSHP, që do të thotë se të gjitha kompetencat me ekzekutiv dhe vendimmarrës në kontekstin si më sipër (me përjashtim të rasteve, kur ai/ajo është anëtare e panelit), i takojnë Kryetarit të OSHP. Përderisa, në kuptim të nenit 98 të LPP, sekretaria, respektivisht administrata, ushtron në mënyrë të rregullt funksione të mbështetjes për Kryetarin dhe Bordin. Aktualisht OSHP ka të aprovuara gjithsejtë njëzetepesë (25) pozita për nëpunës civil nga Kuvendi i Kosovës.

7.1. Bordi dhe Administrata

	POZITAT	KATEGORIA	LEGJISLACIONI
1	Kryetari/rja	I/e emëruar	Ligji për Prokurimin Publik
2	Bordi i OSHP	Të emëruar	të Republikës së Kosovës
3	Sekretariati	i/e zgjidhur	Ligjit për Shërbyesit Civil
4	Administrata	i/e të zgjedhur	

7.2. Struktura e të punësuarve

	Pozita	Numri	Koeficienti
1	Kryesues i Sekretariatit	1	/
2	Udhëheqës i Divizionit për Pranimin e Ankesave	1	10
3	Udhëheqës i Divizionit të Brendshëm	1	10
4	Ekspert Shqyrtues	6	9
5	Zyrtarë të Lartë Ligjor	2	8
6	Zyrtar Kryesor për Financa	1	10
7	Menaxhere e Personelit	1	9
8	Zyrtar për Pranimin e Ankesave	1	7
9	Zyrtar për të Hyra Financiare	1	7
10	Përkthyese (anglisht – shqip dhe anasjelltas)	1	8
11	Asistent ekzekutiv (të Paneleve Shqyrtuese)	1	6
12	Asistente Administrative	1	8
13	Drejtues automjeti	1	6
	Gjithsejtë	19	/

7.3. Lëvizja e stafit

1	Janar 2022	22/njëzetë e dy, ishte numri i të punësuarve;
2	Gjatë vitit 2022	4/katër nëpunës kanë dhëne dorëheqje
3	30.09.2022	3/tre zyrtar të larguar me vendim të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës
4	23.06.2022	Është emëruar Bordi i OSHP
5	01.08.2022	E punësuar 1/një Asistente Ekzekutive
6	01.08.2022	I punësuar 1/një drejtues për Kryetaren
7	25.10.2022	Një anëtare e Bordit- ka dhënë dorëheqje
8	Nëntor 2022	Rekrutuar 1/një Ekspert Shqyrtues
9	Nëntor 2022	Rekrutuar 1/një Zyrtar të Lart Ligjor
10	Dhjetor 2022,	Konkurs të jashtëm për 1/një Zyrtar të lartë ligjor

7.4. ORGANOGRAMI I OSHP



7.5. Trajnimet

Gjatë vitit 2022 janë organizuar këto trajnime për stafin e OSHP:

1. "Planifikimi Strategjik i Buxhetit dhe Ndryshimet Buxhetore" organizuar nga IKAP, mbajtur me 15 mars 2022;
2. "KBFP, Doracaku për Menaxhim Financiar dhe Kontroll" organizuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), mbajtur me 19, 20, 21, 22 korrik 2022;
3. "Transferimi, pezullimi dhe përfundimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil" organizuar nga IKAP, mbajtur me 22 shtator 2022;
4. Takim pune i organeve shqyrtuese të prokurimit publik të Evropës Juglindore, organizuar nga "Komisioni i Prokurimit Publik të Republikës së Shqipërisë" i mbajtur më datat: 27, 28, 29 tetor 2022;
5. "Ngritja e performancës së organizatave buxhetore dhe zbatimi i rekomandimeve nga Raporti Vjetor i Auditimit 2021" organizuar nga MFPT, në bashkëpunim me Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA) dhe USAID, mbajtur me 08 nëntor 2022;
6. "Legjislacioni i prokurimit, e-prokurimi dhe menaxhimi i kontratave, Përmes e-prokurimit" organizuar nga "Prudencia Consulting" mbajte 17, 18, 19, 20 nëntor 2022;
7. "Procedurat e shqyrtimit administrativ dhe administrimi i punëve në zyrë" organizuar nga "Prudencia Consulting" mbajtur me 17, 18, 19, 20 nëntor 2022;
8. "Procesi i Klasifikimit të Vendeve të Punës për Zyrtarët Publik" organizuar nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik - MPB, i mbështetur nga projekti i Bashkimit Evropian, mbajtur me 15 dhjetor 2022;
9. "Procedurat e Shqyrtimit Administrativ dhe Administrimi i Punëve në Zyrë", organizuar nga "Prudencia Consulting", i mbajtur me 08, 09, 10, 11 dhjetor 2022;
10. "Vlerësimi i performancës për nëpunësit civil" organizuar nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik - MPB, mbështetur nga projekti i Bashkimit Evropian, mbajtur me 23 dhjetor 2022.

8. SFIDAT

1. Nga data 25 tetor 2022 njëri nga anëtarët e Bordit ka dhënë dorëheqje dhe për pasojë Bordi aktual i OSHP funksionon tani vetëm me 4/katër anëtarë. Për ketë arsye, Panelet Shqyrtuese nuk mund të caktohen më në përbërje nga 5/pesë anëtarë, sikurse parashihet me nenin 106 të LPP dhe kjo përbën një ngarkesë mjaft serioze për punë efektive të bordit në raport me numrin e konsiderueshëm të ankesave.

2. Afatet brenda të cilit duhet të vendoset në mënyrë meritore për një lëndë (çështje kontestuese) janë të parashikuara shprehimisht me LPP, sepse i referohen normës me karakter kogent-detyrues, kurse brenda këtij afati duhet ndërmarrë një varg veprimesh, vlerësimin paraprak të lëndës, angazhimin e ekspertit shqyrtues sikurse kërkohet kjo sipas nenit 113 dhe 114 të LPP. Afati brenda të cilit eksperti zbaton hulumtim dhe përgatit raportin, përfshin (pothuajse rregullisht) deri në 10 ditë, të cilat automatikisht zbresin afatin e bordit për shqyrtim dhe vendosje meritore. Nga ana tjetër në kuptim të nenit 104 paragrafi 1, të LPP, kërkohet shprehimisht nga bordi që, cituar: "procedura e shqyrtimit të prokurimit do të realizohet në mënyrë, të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës në fjalë". Prandaj siç është shpjeguar më sipër, një kontingjent i tillë i lëndëve, me një numër të kufizuar të stafit dhe me përbërjen jo komplete të bordit, përbën vërtetë një sfidë të pamohueshme për ushtrimin efektiv të mandatit të OSHP-së.

3. Sipas Auditorit të jashtëm, është konstatuar se aktet e brendshme nënligjore të OSHP nuk janë në harmoni me legjislacionin andaj ky fakt përbën një detyrim që domosdo aktet në rastin konkret ti nënshtrohen korrigjimeve dhe ose plotësimeve. Ndër tjera duhet theksuar se Rregullorja për sistematizimin e vendeve të punës nuk është në harmoni me Ligjin për shërbyesit civil. Po ashtu mungojnë disa nga rregulloret e brendshme si Rregullorja për angazhimin e ekspertëve; Kodi i Etikës; Rregullorja për komunikim me media, e tjera.

4. Perceptimi negativ, është një rrethanë e cila është trashëguar nga puna paraprake e këtij Institucioni me të cilën akoma vazhdon të ballafaqohet. Prandaj Bordi aktual gjatë këtij viti është munduar të marrë vendime të unifikuara dhe të qarta në rastet kur aktivitet e Prokurimit janë kthyer në rivlerësim duke dhënë sqarime të mjaftueshme lidhur me përgjegjshmërinë e OE-ve (qoftë ankues, apo OE të rekomanduar) dhe rekomandime eventuale për AK. OSHP do të trajtojë me seriozitet uljen e numrit të ankesave dhe mundësinë e trajnimit të stafit, si dhe shqyrtimin e ankesave në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, me numër adekuat stafi, duke i pasur parasysh praktikat më të mira të Bashkimit Evropian. OSHP për vitin 2023 planifikon të mbulojë objektiva dhe aktivitete të cilat në përgjithësi synojnë:

- Rritjen e besueshmërisë dhe perceptimit në OSHP;
- Automatizim/digjitalizim të proceseve të punës brenda OSHP;
- Koordinim dhe bashkëpunim të ngushtë me institucionet me të cilat ndër vepron OSHP;
- Rritjen e nivelit të transparencës në komunikim me publikun dhe shoqërinë civile;

8.1. Nevojat për punëtor të rijnë:

OSHP ushtron funksionet e tij/sajë me tiparet e një institucion kuazi-gjyqësor i cili në mënyrë të vazhdueshme përballet me një numër të konsiderueshëm të lëndëve, kurse i gjithë stafi i OSHP është i angazhuar me pozita shtesë për shkak të numrit të vogël të pozitave. Për ketë arsye, Kryetarja e OSHP ka kërkuar në disa raste nga Komisioni Parlamentar për Punë, Buxhet dhe Transfere, të lejohet rritja e buxhetit ose ndryshimet në linjat e kërkesës buxhetore, sepse është më se e domosdoshme që administrata e këtij Institucioni të kompletohet me pozitat si në vijim:

	Pozita	***Numri i nevojshëm***	***Nevojat***
1	Ekspertë të brendshëm	6	zvogëlohet numri i angazhuar i ekspertëve të jashtëm të cilët shpenzojnë një pjesë të konsiderueshme të buxhetit.
2	Bashkëpunëtor profesional	5	mbështetja për Kryetaren dhe Bordin në hartimin e akteve dhe përfaqësime në gjykatë
3	Zyra e Pranimit të Ankesave	2	Pranimi i përditshëm i ankesave, kërkesave për diskualifikim dhe shkresave të tjera.
5	Zyrtarë të IT	2	mirëmbajtja të SML, rrjetit dhe publikimet e përditshme
6	Zyrtarë për informim	1	Për informimin publik

Sa për krahasim:
Pothuajse që të gjitha institucionet tjera të administratës publike kanë në përbërjen e stafit të tyre po ashtu edhe punonjës, si: zyrtar zotues, zyrtar certifikues, zyrtar për informim, zyrtar shpenzues, zyrtar për mbrojtjen e të dhënave personale, zyrtar ndërlidhës me institucionet dhe agjencitë e pavarura, zyrtar për pranim të dhuratave dhe deklarimin e pasurisë; zyrtar për mbajtjen e parave të imëta dhe tërheqjen dhe kthimin e avanseve, zyrtar për integrime evropiane, zyrtar i pasurisë, zyrtar për konflikt të interesit, zyrtar i rrjetit për politikë të gjuhëve, zyrtar i logjistikës, zyrtar sinjalizues, zyrtar për pranim të mallit, e tjera. Përderisa pozitat e tilla në OSHP nuk ka ngase detyrimet eventuale që burojnë eventualisht nga ato, kryhen nga stafi aktual.

9. MARRËDHËNIA ME PUBLIKUN

Një nga prioritet e veprimtarisë së Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2022, ka qenë promovimi i aktivitetit të këtij institucioni, i procedurave të shqyrtimit të ankesave, nga njëra anë dhe rezultateve të arritura në përmbushjen e detyrimit ligjor, nga ana tjetër. Marrëdhëniet me media kanë pasur prioritet përmbushjen e objektivave për të rritur besueshmërinë e operatorëve ekonomik dhe publikut ndaj OSHP. Nga ky bashkëpunim kemi forcuar imazhin si dhe pozicionin e OSHP përball opinionit publik, duke krijuar integritetin e nevojshëm për realizimin e komunikimit me opinionin publik. Rritja e besimit të operatorëve ekonomik ndaj OSHP është mbështetur në shqyrtimin e ankesave, marrjen e vendimeve sa më profesionale, mbajtjen e seancave publike dëgjimore të cilat i nënshtrohen audio incizimit dhe vihen në dispozicion të publikut.

Veprimtaria në drejtim të informimit dhe promovimit të aktivitetit të institucionit, është përqendruar në tre drejtime kryesore:

- Komunikimi i rregullt me mediumet e ndryshme të informimit publik të cilat në mënyrë të vazhdueshme i drejtohen këtij Institucioni për informacione nga më të ndryshme me interes publik për sektorin e prokurimit;
- Mbajtja e tryezave me autoritetet kontraktuese, me operatorët ekonomik dhe/ose asociacionet e ndryshme të bizneseve;
- Digjitalizimi i Sistemit për Menaxhimin e Lëndëve, i instaluar me përkrahjen e Zyrës së Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë;
- Publikimi i Njoftimeve të ndryshme, me interes për OE dhe AK;

Ne faqen zyrtare të OSHP, të gjitha palët vazhdimisht informohen me rrjedhën e procedurës dhe shkresat e lëndës, përfshirë ankesat, ekspertizat, vendimet, urdhëresat, vendimet e gjykatave, përfshirë dhe parashtesat tjera eventuale të palëve. Te gjithë këto informata mund te gjenden ne adresën tone zyrtare elektronike oshp.rks-gov.net dhe kjo faqe mirëmbahet dhe freskohet çdo dite dhe njëkohësisht vendosen shkresat ne dy gjuhët zyrtare dhe ne gjuhen angleze.

10. ASETET

